ARCHIVAL POST

# Mirash Ivanaj’s Files (1935–1948): Political Activity, Investigations, and the Military Court Sentence

chival documents reflecting his activities inside and outside Albania, political contacts, and the court decision sentencing him to 7 years in prison and confiscation of property



MINISTRIJA E PUNËVE TË MBRENDËSHME
DREJTORIJA E SIGURIMIT SHTETIT

DEKLASIFIKUAR

Nr.: 1160

Dosje Nr.

Gjeneralitetet Personale

Emni e Mbiemni: Mirash Ivanaj
Pseudonimi
Emni i Babës: Pool
i Nanës: Loge
lindur
I martuar
emni i gruas
Rrethi i ngushtë familjarë
Dat lindja: 1891
vend lindja: Podgorice
Profesjoni: Mësues
vend banimi i përhershëm: Tirane
Nënshtetsija: Shqipt.
Kombësija: Shqipt.
Katolike
Tendenca politike
Lidhjet
Numri i materjalit të hetuesisë
Nr. i Ndjekjes

Drejtorija e Sigurimit Shtetit: Tirane
Seksioni:
Prefektura:
Nën-prefektura:
Referenti:

SECTION

Historical figures

PERIOD

1945 - 1964

MEDIA #1

# Media 1

MEDIA ITEMS #1



REPUBLIKA POPULLORE SHQIPERISE
PROKURORIJA USHTARAKE GARNIZONIT
Nr. 89 Regj.Th.

V. F. L. P.
Tirane,me 2 Prill 1948

**Akt-Akuze**

**GJYKATES USHTARAKE TE GARNIZONIT**

**Ketu**

Sikurse do te konstatohet dhe nga proçes-verbali qe bashkangjitur ju sillet,i pandehuri MIRASH IVANAI,i bir'i Dodes dhe i Zoges,vjeç 57,lindur ne Titograd,i rreshtuare, akuzohet se:

Si minister i regjimit te Zogut,mundohet me çdo menyre qe te mbaje te forte kete regjim duke tentue te dizorientoje elementet anti-Zogiste me ane reformash te dekretueme vetem ne leter.Aftesija dhe besnikerija per regjimin anti popullor te Zogut e çon kryetar te Keshillit te Shtetit deri ne Prill 1939.-

Ne ditet e okupacionit arratiset per ne Greqi bashke me kliken e prej kendej ne Turqi ku jeton duke qene i fornizuem prej agjentave te huej si Englezin Sterlig etje. Per qellime t'imperializmit Anglo-Amerikan formon komitete ne Jeruzalem e vende te tjera.ne vitin 1945,nen urdherat e Anglo- Amerikanevet kthenet ne Shqiperi per te kunder-veprue Pushtetin Popullor,i rekomanduem prej agjentuareve te hueja per elementat qe do te bashkepunonte mer kontakt me Kost Boshnjakun,Ali Bakiun,Gjergj Kokoshin e tjere dhe se bashku me 'ta,hstron çeshtje t'organizimit dhe rruges qe duhej t'ecnin per te permbysur Pushtetin Popullor.Kudo propagandon ner elemente te njoftun te cilet mundohet t'i hedhe n'aktivitet kundra Pushtetit Popullor.Eshte ne dijeni t'egzistences s'organizates se deputeteve tradhtare dhe perkrah progralin e tyre terrorist.

Mqe faji i tij parashikohet prej Nen.________te Ligj. Nr.372 date 12/XII/1946,eshte pare e nevojshme te gjykohet.

P r a n d a j ,

Kerkoj te gjykohet dhe mbassi t'i provohet faji,ne perfundim te vendoset denimi i tij ne baze te Nen.________ ligjit siperm.

Prokurori Ushtarak
Kapiten II-te(F.Makani)

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

MEDIA #2

# Media 2

MEDIA ITEMS #1



(19

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË

Prokurorija Publike e Prefektures

Seksioni i Sigurimit

Nr. i Aktit

Nr. 297/I Prot.

URDHËNESË PARABURGIMI

Sot me I9 të muajit Maj të vitit 1947 në Prokurori Publik I Prefektures i ngarkuar me hetimet, passi shqyrtuam çeshtjen që i përket të pandehunit Mirash Ivanaj

që akuzohet se me datë per faje penale kunder popullit dhe Shtetit

duke marë parasysh se nga provat e deritashme që janë

bëhet e besueshme akuza që rëndon mbi të pandehurin në fjalë, duke marë parasysh se ekzistojnë kushtet e germës të nenit 9 të urdhënesës Pr. Përgjithëshme Nr. 2 dt. 1-XI-946,

duke marë parasysh se vepra parashikohet si faj prej nenit 3 & 8 dhe IO te ligj.372 dhe pas-sjell një dënim që kalon në maximum pese vjetet në bazë të paragrafit Ite të nenit 10 po të asaj urdhënese

URDHËNOJMË

Paraburgimin e të pandehur[1]it Mirash Ivanaj dhe shoqërimin e tij në burgun e Armiqve te Popullit

Kopja e kësaj urdhënese bashkë me letër-rreshtimin dorëzohet të pandehurit i cili ka të drejtë kundërshtimi brenda tri ditëve nga e nesërmja e njoftimit, pranë Prokurorit Publik më të lartë.

P. PROKURORI PUBLIK

(Xhavid Struga)

M' u dorëzua kopja e kësaj urdhënese me gjith letër-rreshtimin sot me datë 21-V-47 në

NJOFTUESI:

I PANDEHURI:

Mirash Ivanaj

[1] Plotsohet sipas rastit, nëse është një ose shumë të pandehur.

ADSH

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

# Media 3

MEDIA ITEMS #1



5

V E N D I M

N'EMER TE POPULLIT SHQIPTAR

Trypi Gjykus i Gjykates Ushtarake te Garnizonit Tiranes i formuare prej
Kapiten I-r Abdyl Hakiu Kryetar
Kapiten II- Shaban Rezha Antar
Aspirant Sali Cela ""

Duke u ndodhur gati dhe Prokurori Ushtarak i Garnizonit Tiranes Kapiten Petrit Hakani,t'asistuare prej Sekretarit Reshter Arqile Mihali,te mbledhur nau diencen gjyqsore sot me dt.7.4.948 mori kete:

V e n d i m:

Ne çeshtje penale te regjistruar nen Nr. 219 te radhorit themeltar te ketija vjeti kundra:

1)MIRASH IVANAJ,ibir'i Dodes dhe i Zogas,vjeç 59,lindur ne Titë-grad e banus ne Tirane,me profesion arsimtar,me shtetesi Shqiptar,ne gjendje ekonomike te mire,i pa martuare,i pa denuare ,gjate regjimit zogollian ka qene Minister i arsimit dhe me vone Kryetar i Keshillitte Ministrave,me arsim te nalte,qysh nga ~~dita~~ 7.Prill 939 se bashku me regjencen e kompanin e zogut eshte aratisur nga Shqiperija,iarestuare me dt.15.Maj 947.

I a k u z u a r:

Me akt-akuzen e Prokurorise Ushtarake te Garnizonit Tiranes per shak se

Si Minister i regjimit te zogut mundohet te te mbaje te forte kete regj duke tentuare qe te dizorjentoje elementat anti-zogiste me ane reformash te dek retuara ne leter,aftesija dhe besnikerija per regjimi.. e zogut e con kryetar te Shtetit Deri ne Prill te vjetit 939.

Ne ditet e okupacionit aratiset bashke me kliken ne Greqi prej ketu ne Turqi ku jeton i furnizuare prej agjenteve te huaj si englezit Sterling etj.Per qellime te imperjalizmit formon komitetin ne Jeruzalem e ne vende te tjera.Ne vi tin 945 me urdher te aglo-amerikaneve kthehet ne Shqiperi per te kundervepruare Pushtetin Popullor,i rekumanduare prejagjenturave te huaja per elementat qe do te bashkepunonte me kontakt me Kot Boshnjaku,Ali Bakiun,Gjergj Kokoshin,etj.dhe se bashku me ta shtron çeshtjen e organizimit dhe rrugen qe duhesh te ecnin per per mbysjen e Pushtetit Popullor.Ku do prapagandon ne elementa te njoftun dhe mundo-het ti hedhi ne aktivitet per kundra Pushtetit Popullor.Eshte ne dijeni te ekzis tences te organizates se deputeteve tradhetare.

G j y k a t a

Passi lexoj proçes-verbalin e hetusis.
Passi ndegjoj apollogjin e te pandehunit.
Passi ndegjoj pretencen e Prokurorit qe per arsye te treguara ne te kerkojti qe ipandehuni te deklarohet fajtor dhe te vendosej denimi i tija me 7 vjet privim lirije ,konfiskimin e pasunis se tij dhe humbjen e te drejtave civile e Politike.
Passi ndegjojti fjalen e fundit te se pandehunit.
Passi studijojti proçes-verbalin e rjedhimit te gjykimit.

O B S E R V O N:

Se ipandehuni MARASH IVANAJ:ka qenur Minister i regjimit te urier zogo lliane dhe Kryetar i Keshillit te Shtetit deri ne diteh e okupimit te Shqiperis nga Fashizmi Italiane.Nje nga elementat me besnik te klikes se zogut jo vetem qe nga vjeti 924 deri me 939,por edhe me largimin e zogut ipandehuni nuk i ndahet po u largua bashke me te duke tradhetuare Popullin dhe Atdheun.Te cilet mbasi e shf rytezuane deri ne palce ja doreszuane okupatorit Fashiste dhe vete duallne ja-sh te duke bere qejf me gjakun e tija.

MEDIA ITEMS #2



(2)

Gjate kohes qe ka qendruare jashte ka pasun lidhje me zogun dhe kliken tjeter te tija dhe axhenta te tjere te S.B.S. si konsulli i zogut Xhaxhuli, englezin Sterling .Eshte munduare per te formuare Komitetin per te punuare ne favor te englo-amerikaneve.

Mbas clirimit te Shqiperise ipandehuni kthehet ne Shqiperi dhe si mbas udhezimeve te mara nga reaksioni anglo-amerikan vepron kundra Pushtetit Popullor duke u lidhur dhe bashkepunuare me Gjergj Kokoshin,Ali Bakine,etj.Eshte vene ne dijeni mbi ekzistencen e organizates se Deputeteve tradhetare ,ka prapaganda-are ~~kudo~~ e axhituare kudo per kundra Pushtetit Popullor.

Faji i tij urpvua plotesisht nga raporti i seksionit te sigurimit te Shtetit,dhe pjeserisht nga deponimet e tija.,dhe parashikohet si faj prej Nenit 3 paragrafit 8,dhe Nenit 8 te Ligjes Nr.372 date 12.XII.946.

P r a n d a j:

Per te gjitha keto bashkerisht dhe konform kerkimit te Prokurorit ne baze te Nenit te 4 te Ligjes se siperme.

V E N D O S I

Fajsin e ndeshkimin e fajtorit MIRASH IVANAJ,me 7(shtate)vjet privim lirije,konfiskimin e pasunis se tij te lujteshme e te palujteshme,si dhe me hum bjen e te drejtave civile e Politike per 5 vjet.

Vuajtja e ndeshkimit i fillon nga dt. e arestimit.pune te detyrushme baraz me kohen e ndeshkimit.

Te denuarit i ngarkohen shpenzime gjyqsore lek 54.

Tirane,me 7.IV.948.-

SEKRETARI ANTAR ANTAR KRYETAR

AIDSSH

## INFORMATION

No additional information is available for this media.

## TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

MEDIA #4

# Media 4

MEDIA ITEMS #1



14

Vdekje fashizmit Liri Popullit

Gjyqit te Garnizonit – Tiranë
për
Gjyqin e Naltë Ushtarak

Apelloj mbrenda afatit ligjuer Vendimin e Gjyqit te Garnizonit te Tiranës, dhânun më 7 te k.m., me te cilin dënohem me 7 vjetë privim lirije, punim te detyrëshëm dhe konfiskim te pasunis së luejtëshme dhe te paluejtëshme.

Në rasë se fakti që m'atribuohet konsiderohet faj, deklaroj se s'ka pasë ndonji qellim te keq, dhe i lutem atij te Naltit Gjyq që, në rishikimin e çështjes s'ime, te tregoje zëmërgjânësi, tue pasë parasysh gjendjen t'ime ekonomike fare te këputun e gjendjen shëndetësore te keqe, dhe te m'a transformojë dënimin në kondicionel, tue më dhânë kështu mundësi që ditët e fundit te pleqnis s'ime t'ia kushtojë, me at kontribut që mundem, popullit e Pushtetit.

Tiranë, 10. IV. 1948

Apelluesi:
Mirash Ivanaj
burgosun në Burgun e Tiranës
t'arm. te popullit.

AIDSSH

## INFORMATION

No additional information is available for this media.

## TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

MEDIA #5

# Media 5

MEDIA ITEMS #1


F.1 № 6-7/12

1 Mirash Ivanaj
2 Boda
3 Zoga
4 I pamartuar
5 S'ka
6 S'ka
7 1891
8 Potgorica (Jugosllavi)
9 Profesor.
10 Tiranë
11 Tirana e Re
12 Perlat Rrexhepi № 3
13 Shqiptar
14 ~~Shqi~~ Jugosllav
15 Katolik.

AIDSSH

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

MEDIA #6

# Media 6

MEDIA ITEMS #1



VDEKJE FASHIZMIT LIRI POPULLIT
Tirane me 3.X.945

RAPORT MBI LEVIZJET E MIRASH IVANAJT

Me daten 1 ne oren 16 ne Hotel Kontinental erdhi Mirash Iavanaj,
dhe po pinte ne Bufe.Mbas 5 minutash vjen Gjergj Kokoshi dhe ta
kohet me te se bashku me te vellan e Mirashit qe quhet Nikolla,ke
ta bizeduan I0 minuta.Pastaj dalin nga Hoteli dhe shkojne ne kesh
llin e N/Prefektures se Tiranes,Mirashi dhe Gjergji hypen siper k
rse tjetri priti poshte.Mbasi ndenjen nja IO minuta dalin dhe shk
jne prape ne Kontinental.Ne oren I6.30 vjen ne Hotel Petro Marku
me te shoqen(kjo takohet shpesh me engleze).Keta takohen dhe mbas
pershendeten fillojne te bizedojne qe te peste.Ne oren I6.40 vijn
ca engleze midis te cileve dy majora.Ne oren I6.50 vjen Mustafa
Greblledhi,redaktor i Gazetes Bashkimi,nje kohesisht dhe tre gaze
are te tjere.Ne oren 17 vjen Konsulli italian me oficera engleze
dhe amerikane,gjithashtu dhe keta t fundit takohen me Mirashin.N
oren I7.5 vijne tre vete qe kane pase ndejte ne Legaten turke,mba-
si u takuan te gjith filluan te bizedojne ne gjuhen ferngjishte,p
e hulshin zerin sa here qe ... hynte ndonje i pa njohur.Mae ket
mori pjese aktive dhe Drejtori i Hotelit Beqmah Ndreu.Ne oren I8
fillojnete dalin.Se pari hikin englezet dhe me von tre personat e
ish Legates turke bashke me konsullin italian.Mbasi ikin keta vje
Kiko Sherko dhe Nodda Bulka,por ky nuk takohet me Mirashin,kurse
Kiko Takohet me te dhe fillon te bizedoi.Ne oren I8.I8 Petro Mark
me te shoqen ikin nje kohesisht dhe gazetaret.Ne oren I8.20 Mira
shi me Gjergjin dalin dhe takojne me Ali Bakine,keshtu qe te tre
dalin me shetitur.Kur ishin mbeshtjelle gjith ata persona ishte a
dhe Suat Asllani,i cili kishte marre pjese aktive ne bizede.Ne ore
22 erdhi prape Mirashi bashke me Gjergjin ne Kontinental dhe past
je duelen rishtas.

Me daten 2 k.m.neoren 8 erdhi Gjergji ne Kontinental dhe se bashk
me disa miq duelen jashte.Mirash Ivanaj ne kete date ka bere keto
levizje:Prej ores 11 deri ne I2 para dite eshte sjellur rrotull pa
zarit duke filluar nga Kafe London,Bolonja,shkoi ne rrugen e Dibre
i shoqeruar nga nje i shkurter me nje kapele republike,ne nje mosh
te kaluar me rrobe grixho.Deri ne mes te rruges shkoi pa u futur
ne ndonje dyqan dhe u kthye persei nga Bulevardi(ketu u nda nga pe
rsoni qe e shoqeroj) dhe mori anen e majte duke shikuar librat ne
barakat(karshi bashkise).Ne oren I2 shkoi ne Kafe Splendit e prej
aty ne Hotel Kontinental.Mbas dite doli nga hoteli ne oren 2.30(me
oren e vjeter).Para Kontinentalit u takua me Elmaz............
mesues ne shkolla fillore,(eshte i trashe me gjalyke te bardhe ne
fytyre).Shkoi me kete deri te Argus-i dhe ketu u ndane.Mirashi mo
ri rrugen e Postes(shu e ndadal dhe duke shikur te gjitha vitrinat
e dyqaneve).Kur mbrrini te ish Posta mori rrugen e Pishes dhe mbr
ne fund fare(afer shtepise se Mustafa Krujes),u fut ne shtepin e S
Sali Saganit ne kete rruge,ne kete kohe qe ora 3.30.Ne oren 5.30
doli nga kjo shtepi i shoqeruar nga Saliu vete.Kur mbrrini te Komi
teti Mysilman u nda nga Saliu dhe hy ri ne Kontinental.Mbas 5 minu
tash doli perseri nga Kontinentali dhe shkoi ne Kryeministri ku nd
jti deri ne oren 8.Me te dale ketej shkoi ne Kontinental nga ku
nuk doli me.ESHTE NE VEZHGIM.

SHEF I SEKSIONIT TE II_te
( Dhosi Progri )
Dhosi Pr

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

MEDIA #7

# Media 7

MEDIA ITEMS #1



16345

(15

Pranë Institutit Studimeve qëndron arshiva me korespondencën personale të Mirash Ivanajt, Lumo Skëndos, Lef Nosit etj. Në arshivën e Mirash Ivanajt është gjindur një lutje e të dyshimtit Age Bojaxhiut drejtuar nënës Mbretereshe të Zogut, ka mundësi që n'atë arkivë të ndodhen dorëshkrime me karakter politik të personave të më sipërme. Është mirë që këto të kontrollohen nji herë nga organet e Sigurimit sepse mund të kenë gjerë me vleftë. Pranë Institutit kohën e fundit janë ngarkuar 2 shoqe për kontrollimin e tyre për këyesisht të ngarkuara me këtë punë janë: [redacted], [redacted] dhe [redacted]. Ka shumë probabilitet që këta të shdukin dokumentat që i vlejnë Sig. Këto nuk janë kontrolluar asnji herë nga ana t'onë, ashtu sikundër kanë qënë në shtëpit e të sipërmëve janë marrë prej Institutit Studimeve. [redacted] dhe [redacted] [redacted] e kanë organizuar këtë punë.-

Data, më 18/V/1948.-

Nga N/Seksion'i Pushtetit

U shtyp në 6 kopje.-

5r

AIDSSH

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

# Media 8

MEDIA ITEMS #1



131

BIOGRAFIJA E MIRASH IVANAJT

Rrjedh prej nje familjeje borgjeze te mesme;eshte nga malesi
te e Shkodres.Ka kryer studimet e larta ne Itali.Ka dy doktorata,nje
ne Letersi e tjetren ne Drejtesi.Mbas kryerjes se studimeve u kthye
ne Shqieri dhe u emerua si Profesor ne Liceun e Shkodres e te Tira
nes ne vitin I926-27.Gjith rrethi i tij familjar ka qene intelektual
me gjith se jane nga Malesija e Madhe.U be Ministre Aresimi ne vitin
I936.Si i tille veproi ne Kabinetin e atehereshlme deri ne ikjen e
tije ne vitin 939.Qendrimi i tije ka qene shembellor.Ishte reformist
dhe ky ka qene shkaku qe me Zogon nuk ka shkuar dhe aq mire..Ka qene
ne kundershtim me te nga lidhje qe kishte me italianet ky i fundit.
Ka qene Anti-italian i terbuar dhe Anti-klerikal.Per qendrim te duk
shem kunder klerit,ky i fundit mori dhe masa tue e nxjerre jashte
tije.Shkaku kryesor qe ky ishte kundershtar i klerit ,ka qene se ky
ishte i organizuar ne Masoneri.Gjith familja e tije ka qene te po nj
ideje.Nje kusheri i tije i quajturi Nikolla ka qene kryetar i Masone
ve ketu ne Shqiperi.Si Anti-italian u pa veçanerisht ne shtetezimin
e shkollave veçanerisht.Qendrimi tij ne lidhje me mbylljen e shkolla
ve minoritare ka qene nje pasoje e hidhur per popullin Shqipetar,ne
perfaqesimin e tije ne Lidhjen e Kombeve.Ketej kuptohet se nuk ka pa
se nje pjekuni politike dhe nuk ka ditur te manevroje.Ka qene njeri
shume i ndershme dhe kundershtar i rrepte i rrushfeteve.Tregojne shu
me historira si kundershtar i Musa Jukes dhe klikes se Zogut.I,ka
denuar rende atas qe abuzonin.Zogun nuk e ka dashte si person,por ve
tem me qene se gjendja ishte e çrregullte ka dashur qe neper mjet ti
je te beheshin nje tok,reformash e mos te ngjinin çrregullime.Nga na
tyra eshte mjafte i ftohet dhe si karakteristike e tije misantrop.Ky
nuk ka pasur miqesi me as nje.Puna e tije konsistonte nga shtepija n
ne zyre dhe anasjelltas.Ne shtepi e kalonte kohen me studime;ka nje
kulture shume te zhvilluar.Miqesi,ka pase me Ali Bakiun dhe shpeshe
here i shkonte ne shtepi dhe Demir Vila;me te parin jane shume te
aferte.Edhe gjat okupasionit kane pas korespodènce te rregullte.Per
me teper Ali Bakiut i kishte lene neneadministrimin e tij gjithe pa
surine e tije,qe kishte.

Nga gjendja ekonomike eshte i vetem nga Ministrat e Zogut qe
nuk ka abuzuar dhe per kete nuk ndodhet fort mire.Eshte larguae ne
Prill te 939-tes se bashku me Zogun e suiten e tije.Ka qendruar gji
thnje ne Stamboll.Ne fillim Zogu i dergonte te holla por me von ja
preu.Gjat qendrimit te tije ne Stamboll ka shkuar ne Palestine per
te rene ne kontakt me patriotet Qemal Butken,Abdul Sula etj.per nje
Organizate Pan-Shqipetare,por mbasi nuk rane dakord u kthye prap
ne Stamboll.

Ne lidhje me çeshtjen e zgjedhjeve mund te themi se ky ne
Shkoder e Qarqe nuk ka as nje kredi e kjo rrjeth nga demaskimi siste
matik qe i ben kleri.Mund te kete nje simpathi ne rrethet intelektua
le dhe ne ndonje pjese te Rinise nacionaliste.Eshte fytyre e pa kom-
promentuar dhe shumica e popullit flasin me simpathi per te.

Nje gje dihet per te:se gjat Revolusionit ne Spanje ka qene
simpathizues dhe admirues i republikanve.

Ka qene i martuar me nje italiane nga shkaku se ketu nuk i
jepte njeri grua.

Ne Familje kanpas nje edukim patriarkal,dhe respektonin iera
rkine.

1

ADSSH

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.